



PROCESVERBAL

Mbledhja e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) në Rahovec, e mbajtur më **04.09.2019** me fillim në ora **10:10**. Mbledhjen e kryesoi Kryetari Komunës **Smajl Latifi**. Kuorum për mbajtjen e mbledhjes kemi.

Kryetari- Më lejoni ti përshëndes të gjithë anëtarët e KKSB-së, Nënkryetarin e Komunës, z. Fatmir Iska, drejtorët e drejtorive, komandantin e stacionit të policisë në Rahovec z. Fazli Morina, Përfaqësuesit e organizatave, institucioneve që e përcjellin këtë takim të rregullt të KKSB-së, OSBE-në, përfaqësuesit e klerit fetar, shefin e ZKKK-së z. Lendrit Qeli, përfaqësuesit e mediave dhe gjithë të pranishmit e tjerë që janë prezent në sallë. Ky është takimi i pestë për vitin 2019 i KKSB-së. Propozoj këtë rend dite:

REND DITE

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e komunës së Rahovecit,
Prishja e qetësisë publike nga lokalet e natës dhe personat e papërgjegjshëm,
Trajtimi i mbrojtjes së pyjeve nga dëmtuesit ilegalë,
Vetëdijesimi nga minat dhe mjetet tjera të pashpërthyer nga lufta,
Gjendja e sigurisë në shkolla,
Identifikimi i hapësirave për qasjen e personave me nevoja të veçanta,
Monitorimi dhe raportimi mbi nivelin e sigurisë në shkolla dhe zbatimin e planit për siguri në shkolla,
Siguria në trafik,
Raportimi dhe parandalimi i dhunës në familje,
Rreth veprimeve dhe masave për luftimin e shkelësve të ligjit në komunën e Rahovecit,
3. Të Ndryshme.

Kryetari - E vë në votim rendin e ditës: Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar rendi i ditës. Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës:

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Ka dikush të shtoj diçka sa i përket procesverbalit nga mbledhja e kaluar, nëse jo e vë në votim: Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar procesverbali nga mbledhja e kaluar. Kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës:

2. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e komunës së Rahovecit.

Kryetari- Sipas asaj që ne dijmë si udhëheqje komunale, bindja jonë që është bindje reale, është se gjendja e përgjithshme në komunën e Rahovecit është stabile, e qetë edhe konsideroj e qëndrueshme. Natyrisht që ka pasur plot shqetësime, plot sfida sikurse që ka pasur plot angazhime edhe nga organet komunale, Administrata, Policia edhe nga institucionet e tjera përgjegjëse, për t'i tejkaluar sfidat të cilat i kemi pasur gjatë periudhës kur kanë qenë edhe shumë qytetarë tanë nga bota perëndimore, që kanë ardhur në vendlindje, kanë pasur plot angazhime si Administratë, dhe besoj që nuk kanë munguar edhe përpjekjet që të kapërcehen ose të zbuten shqetësimet të cilat ne i kemi evidentuar gjatë kësaj periudhe. Kemi pasur

ngarkesë të madhe, por kemi pasur probleme dhe sfida të cilat kanë përfunduar. Kemi raste tragjike të humbjes së jetës në komunikacion, besoj për këtë është mire të na njoftoj komandanti i Policisë, për situatat në të cilat ka kaluar komuna jonë, përkatësisht qytetari ynë gjatë kësaj periudhe në mes të dy mbledhjeve të KKSB-së. Faleminderit, fjalën e ka komandanti i stacionit të Policisë në Rahovec, kapiteni Fazli Morina.

Fazli Morina- Faleminderit Kryetar! Faleminderit për ju dhe gjithë pjesëmarrësit në këtë takim! Unë do t'i referohem tre mujorit të fundit me statistika, nuk do t'i përsëris fjalët që tha Kryetari, por do të mundohet të paraqes në pika të shkurtëra për gjendjen e sigurisë. I nderuari Kryetar, gjendja e sigurisë në zonën tonë të përgjegjësisë është e qetë dhe stabile mirëpo me kundërvajtje dhe vepra tjera si zakonisht si çdo kund tjetër. Po filloj nga prishja e rendit dhe qetësisë publike në lokalet e natës dhe personat e papërgjegjshëm. Kështu që duke marrë parasysh periudhën qershor-gusht 2019, Policia e Kosovës përkatësisht njesitë policore të stacionit në Rahovec kanë shqyrtuar 12 gjoba për shkelje të ligjit të rendit dhe qetësisë publike mirëpo nga këto 12 gjoba asnjëra nuk është e shqyrtuar për lokalet e natës. Ndoshta mund të ju elaburoj pak se pikërisht për këto gjoba ndoshta dikush nuk ka njohuri: janë gjoba të cilat Policia, mos ta them tani për afërsisht, është marrë vendim nga Gjykata dhe iu ka dhënë mundësinë Policisë, duke u bazuar në ligjet e aplikueshme, që për rastet e kundërvajtjeve, qofshin ato për sjellje arrogante, për mosmarrëveshje të vogla, kacafytje, tani për tani, policia merr vendim vet aty për aty, edhe nuk iniciohet rasti qysh është inicuar deri më tani dhe i'u është paraqitur gjykatës për kundërvajtje por shqiptohet gjobë me vendim të policisë dhe ajo gjobë është, duke filluar nga shuma 50 deri në 500 euro, kështu që këto 12 gjoba janë të asaj natyre që janë shqiptuar nga vet zyrtarët policor për rastet e ndryshme. Kjo ishte sa për dijeninë tuaj edhe që ka qenë shumë e mirëpritur dhe ka efektin e vet.

Siguria në shkollë- Policia e Kosovës edhe përkundër angazhimeve tjera shtesë që ka në plane operative dhe në projekte të ndryshme i jep mundësi edhe sigurisë nëpër shkollë që gjatë implementimit të planit operativ në vazhdimësi, duke kontrolluar në afërsi të objekteve shkollore, me automjete zyrtare me baza ditore dhe duke angazhuar zyrtarë në rroba civile, mbahen takime dhe kontakte të vazhdueshme me drejtorët si zakonisht deri më tani dhe me zyrtarë tjerë të shkollave përkatëse. Gjatë kësaj periudhe flitet gjithmonë për periudhën qershor-gusht, janë kryer gjithsej 44 vizita në shkollë të ndryshme dhe patrulime edhe pse dihet që mësimi nuk është zhvilluar një kohë të caktuar. Tani fillimi i vitit shkollos, dihet shumë mirë se tash shumë fëmijë ballafaqohen me komunikacionin për herë të parë, kemi nxënës të klasave të para edhe njesitë përkatëse të stacionit policor, sikur edhe në të kaluarën angazhohen për sigurinë në komunikacion në afërsi të shkollave në kuadër të komunës, në përgjithësi duke përfshirë edhe fshatrat për rregullimin e komunikacionit e posaqërisht në afërsi të atyre shkollave që janë të ekspozuara drejtpërdrejtë në rrugën kryesore. Gjatë periudhës qershor-gusht, janë të regjistruara dy raste në objekte shkollore në dy shkollë, spo e shoh të arsyeshme ta elaburoj, ndoshta ska nevojë, pra gjithsej dy raste janë inicuar dhe kanë vazhduar për procedurë të mëtutjeshme për hetime, është njëra për keqtrajtim të detyrës zyrtare dhe tjetra dhunim i dyshuar, mirëpo me to kanë vazhduar hetimet, dikujt ju ka shqiptuar një masë dhe tjetra është duke u hetuar, të shohim në fund se çka do të rezultoj. Siguria në trafik është shqetësuese, e thatë edhe ju Kryetar, kështu që Policia e Kosovës është ka e implementon planin operativ të veçantë të sezonës verore 2019, e thatë shumë mirë se në vendin tonë kanë arritur shume gurbetqarë dhe ka karakteristika të veçanta të cilat kërkojnë aktivitete proaktive shtesë nga Policia e Kosovës. Gjatë ardhjes së bashkatdhetarëve nga vendet perëndimore gjatë muajit qershor-korrik dhe gusht, kemi pasur fluks të madh të bashkatdhetarëve të cilët kanë ardhur në pushime nga vendet e Evropës, me vetura është shkaktuar një rritje e theksuar e numrit të veturave në rrugët e Kosovës, duke mos përjashtuar edhe numrin e madh të aksidenteve. Gjatë kësaj periudhe njesitë e stacionit policor në Rahovec kanë shqiptuar gjithsej 1392 gjoba për kundërvajtje të ndryshme në komunikacion

që do të thotë se është një përqindje pak më e vogël se në periudhën e vitit e kaluar, nga këto janë tejkalimi i shpejtësisë në vendbanime, parkimet e parregullta, vozitje në ndikim të alkoolit ndërsa rastet e aksidenteve me dëme materiale të njesuara vetëm nga stacioni policor në Rahovec krahasuar me periudhën e njëjtë kanë rënie 9 raste po megjithatë janë shumë, 34 aksidente të trafikut gjatë vitit 2018, 25 aksidente janë gjatë këtij viti, për fatin e keq 2 aksidente me fatalitet ku 6 persona veq kanë gjetur vdekjen, 49 aksidente janë me lëndime trupore flitet veq për zonen e Rahovecit, ku nga 49 gjithsej janë 114 të lënduar dhe 24 aksidente vetëm me dëme materiale. Kjo ishte pjesa sa i përket sigurisë në trafik ndërsa te pika tjetër te rastet e dhunës në familje edhe këtu i kemi nxerr bukur disa statistika se është pak shqetësuese sepse është numri në rritje por për dijeninë tuaj do t'i elaborojë, do t'i cek saktë se çka është ndërrmarrë dhe sa kanë qenë. Gjatë kësaj periudhe gjithsej kanë qenë 14 raste të dhunës në familje e që janë shumë, janë arrestuar gjithsej 13 të dyshuar, prej tyre 9 janë mbajtur deri në 30 ditë, do të thotë 9 janë mbajtur, 3 nga ta janë ndaluar në dhomat e mbajtjes në stacionin policor për 48 orë dhe 5 janë liruar në procedurë të rregullt, janë trajtuar 13 viktima gjithsej. Qershori ka qenë me 4 raste, 5 viktima gjithsej dy viktima femra dhe dy meshkuj, 3 persona të ndaluar, dy në 30 ditë, njeri 48 orë dhe njëri në procedurë të rregullt. Këto janë shifrat që përputhen, e që e thash në fillim për të gjitha rastet e përbashkëta, mirëpo nuk do të thotë që gjithmonë dhe çdo herë viktima është vetëm gjinia femrore, shifet qartë këtu sipas statistikave ka edhe të gjinisë mashkullore. Diçka tjetër nuk e kemi parë të rëndësishme për të cekur por nëse dikush ka ndonjë pyetje shtesë për ndonjë rast ose ndonjë gjë konkrete, mund të përgjigjemi, nëse jo, e kemi parasysht, kemi edhe takime tjera dhe mund të përgjigjemi në takime tjera. Unë kaq kisha për fillim kryetar.

Kryetari- Faleminderit komandant, diskutimi është i hapur. Po urdhëro Ymret?

Ymret Reshiti- Faleminderit Kryetar! Përshendetje për të gjithë, unë jam përfaqësues i këshillit të prindërve në nivel komunal. Ajo që neve na brengos si këshill i prindërve është siguria e nxënësve. Nga komuna zakonisht, nga Drejtoria e Arsimit, nga drejtorët e shkollave, ne në vazhdimësi kërkojmë që të kenë plane, pra përkushtim në krijimin e kushteve të nxënësve ose siguria e tyre të jetë e paprekshme qoftë nga drogat edhe gjërat e këqija apo edhe nga konfliktet dhe futja e armëve dhe mjeteve të ftohta nëpër shkolla, d.m.th. neve thjeshtë kërkojmë prapë nga institucionet edhe nga Policia edhe nga Komuna me prioritet ta kenë sigurinë e nxënësve nëpër shkolla. Edhe një shqetësim e kemi: në disa shkolla të mesme, është bërë praktikë të rinjë në moshën 18-vjeqare pa patent shofer zakonisht vozisin shpejtë, ndoshta Komuna kishte mundur të bënte një zgjidhje, me vendos kamera afër shkollave të mesme e kam fjalën në Krushë, në Ratkoc edhe në Rahovec sepse munden me ndodh deri te rastet d.m.th. aksidentet ose shkelja e ndonjë këmbësori. Megjithatë ne falënderojmë DKA-në dhe Komunën që deri tash edhe policinë kanë bërë përpjekje që numri i rasteve që është cënuar siguria e nxënësve nëpër shkolla është shumë e mirë në krahasim me komunat e tjera që kanë probleme shumë të mëdhaja, mirëpo, kjo nuk duhet të na gëzojë, gjithmonë ne duhet të bëjmë më të mirën. Për komandantin e stacionit policor vetëm pata dëshirë me ditë një sqarim, pa detaje të identifikimit të rastit të dytë, dhunim i dyshuar, nëse është i përfshirë ndonjë nxënës aty? Kjo është çka neve na intereson, ama nëse ka të bëjë me stafin mësimor është diçka tjetër.

Kryetari- Falemnderit Ymret, komandant a keni ndonjë sqarim?

Komandanti-Faleminderit, rasti është paraqitur, është ftuar prindi me vajzën, ka shprehur shqetësimet e tij, ankesën në formë të dhunimit mirëpo akoma nuk është vertetuar, është në hetime, personi i dyshimtë deri tani ka qenë në masën e vazhdimës të paraburgimit, nga tash është ndërprerë masa e paraburgimit pra është në arrest shtëpiak mirpo rasti është akoma pa përfunduar, hetimet janë duke vazhduar, nuk është as nxënës as arsimtar edhe rasti ka ndodhur jashtë objektit të shkollës dhe hetimet janë duke vazhduar, këto janë të dhënat që

janë ndërmarrë deri më tani, nuk ka të bëj me personelin arsimor, nuk ka të bëj me prind, ka të bëj me qytetar, kaq kisha më tepër skemi nevojë.

Kryetari- Faleminderit Komandant! Dëshiron dikush tjetër me marr fjalën? Urdhëro baca Ramë.

Ramë Berisha – E përshëndes Kryetarin dhe gjithë stafin, po ashtu edhe gjithë pjesëmarrsit, kur është fjala për siguri në kuadër të komunës siç u fol, gjendja është e mirë por kish me qenë edhe më e mirë sikurse shërbimet pa marr parasysh për këtë popullatë me qenë më të interesuar mirëpo ne nuk e përjashtojmë atë sepse shërbimet e sigurimit edhe shërbimet e tjera që kanë një përgjegjësi të madhe janë gjithmonë ne gatishmëri, unë flas me fakte sepse këto pasiguria edhe dëmet vijnë prej faktorit natyror dhe atë shoqëror, unë po flas për dëmet që bëhen nga dukuritë natyrore prej vitit 2014 e këndeje, me pas raste që se këto shirat sidomos me shumicë ne kohën e vjeshtës dhe të pranverës, kemi pas raste në 2016 –tën kemi pas vërshime të mëdha në gjithë fshatrat e komunës së Rahovecit mirëpo shërbimet e sigurimit kanë qenë gjithmonë aktive dhe kanë qenë në gatishmëri pa marr parasysh a ka qenë mesnatë apo fortunë, kanë qenë gjithmonë të gatshëm dhe unë e përshëndes këtë shërbim se kanë qenë shumë sa ka qenë e mundur, ajo ka rrjedhë prej interesimit të madh të udhëheqjes së komandantit apo kapitenëve tjerë që i japin ato porositi. Janë në shërbim të mirë edhe me kanalizime ata punëtorë edhe me ujësjellës në shërbim të mirë te popullatës. Sa i përket tash te shkollat, flas tash për sigurimin pak a shumë nëpër shkolla, këto bëhen plotësisht, jo rastësisht, por bëhen me qëllime por jo vetëm siguria dhe shërbimi por gjithë popullata që e sheh një punë jo të rregullt rreth shkollës apo institucioneve tjera duhet me qenë të interesuar me lajmëru aty për aty me i dhan vërejtje për një të mbarë sa ma të mirë, sepse çdo e pa mirë ndikon masovikisht, madje unë mendoj këtë tollovi janë duke e bërë mbajtja e telefonave, nuk është e thënë me ju dhan liri të rinjëve, gjithë ai sigurim i këtyre pasojave janë telefonat ,me mbërri ndonjë ligj që mos me u perdorë nëpër shkolla këto teknika, ma mirë të marrin librin që aty janë gjërat e gjalla që janë me prioritare tash. Faliminderit, ju përshëndes të gjithëve!

Kryetari- Unë po përpiqem të bëj një rikapitullim edhe një konkluzë me nxjerrë rreth pikes së parë të rendit të ditës. I falenderoj ata që u kujdesen dhe kontribuan në këtë takim për pikën e parë dhe nënpikat e pikës së parë të rendit të ditës posaqerisht komandantin e stacionit të policisë dhe Ymret Reshitin e Rame Berishen që u angazhuan në ngritjen e shqetësimeve dhe sqarimeve disa rrethanave që lidhen me gjendjen e sigurisë. Ne pa keqkuptime secili institucion i kryen detyrat e veta që burojnë përgjithësi në vijë institucionale dhe natyrisht pamvarsisht kordinimeve që i kemi ne bie fjala me policinë dhe me institucionet tjera, secili i ka detyrat e veta që nganjëherë janë hapur me dashje ose padashje keqkuptime që Policia e Kosovës po ka kundërvajtje po i dënon qytetarët. Unë besoj që as qëllimi i policisë e jo si jo i komunës nuk është për të dënuar dikënd po besoj që dënimet po ashtu kanë ndodhur te ata që kanë bërë kundërvajtje pra kanë shkelur ligjin, nuk ju kanë përmbajtur rregullave të lojës që janë të përcaktuara me kushtetutë dhe ligjet e aplikueshme me ligjet në fuqi. Ne vërtetë i kemi kerkuar Policisë dhe do ti kërkojmë edhe nga ky takim dhe do ti kërkojmë edhe në emër tuajin do ti kërkoj si udhëheqës i këshillit komunal për siguri në bashkësi edhe në emër tuajin edhe në emër të qytetarëve që ti lirojnë trotualet, hapësirat publike, trotuari është për këmbësorët, për qytetarët, për nxënësit, për fëmijët, nuk është për automjetet, aq sa kemi trotuare ato ti kemi të lira, natyrisht ne nuk mund ta dënojmë askënd, inspektori jonë nuk mundet të dënojë sepse policia është kompetente për ta shqiptuar kundërvajtje ndaj dikujt që ka shkelë rregulla, ju lutem jepeni kontributin edhe ju që mos të bëhemi peng i mosveprimit për t'i liruar hapësirat publike, trotualet dhe me na ndodhë ndonjë situatë me fatalitet, shumë më e rëndësishme është një jetë njeriu, pra është jetike me marr masa me mbrojtë jetën e njeriut se sa ekspozimi i nje malli të një pronarit cilido qoftë deri në asfalt apo vendosja e karrikave jo vetëm në trotuar por edhe në asfalt. Ne jemi të pakompromisë edhe zërat të cilat

nganjëherë me dashje apo padashje vijnë në adresë të udhëheqjes komunale asnjëher nuk kanë asnjë qytetarë i këtij vendi, i kësaj komune sa të jem unë Kryetar nuk ka me i dhanë të drejtë ose nuk ka me mbërri mem mbindë, me lut Policinë e Kosovës mos vepro në qoftë se ka shkelje, natyrisht edhe qellimi i Policisë së Kosovës, është të jep mesazhe për edukim, vetëdijësim, ndërgjegjësim etj, por ne nuk mund të tolerojmë bllokimin e trotuarit, njëherazi ecjen e këmbësorëve nëper asfalt, nuk e tolerojmë dhe nuk kemi me tolerue, po ju kerkoj edhe në emër tuajin, le të del edhe mesazhi nëpër media se ne nuk duhet me pritë a na ndodhë diqka e madhe, në emër të mosveprimit për shkak se po u dëmtoka një biznes, nuk dëmtohet biznesi kurrë dhe askush nëse e shfrytëzon hapsirën e lejuar me ligj pra nëse ska hapsirë në atë lokacion ku ai zhvillon veprimtarinë mundë t'i drejtohet komunës për një hapsirë tjetër, por jo 3 apo 4 vetë në qytetin tonë me i bo kaq shumë problem policisë e kaq shumë probleme inspektoratit e kaq shumë probleme komunës së Rahovecit kur ekspozon ato mallrat ditën e natën e kur shpenzon energji e karburante e kaniher edhe pakuptim policia e inspektorati jonë sapo i kryen punët e ata vazhdojnë t'i përserisin të njejtat veprime. Nuk do të lejoj, nuk do të jetë gjatë do ta kërkoj edhe arrestimin e atyre njerzve që dëshirojnë me prish imazhin e mirë të një qyteti ose të një komune që janë njerëz punëtor, njerëz të vyeshëm, njerëz të zellshëm, njerëz që e nxjerrin bukën me djersën e vet. Pra nuk jam kundër askujt por nuk mund të tolerojmë që të mos veprojnë aktivisht organet tona qofshin komunale qofshin Policia apo institucionet tjera kompetente. Unë edhe nga ky takim kërkoj me i liru trotuaret, Komandant, e ftoj inspektoratin tonë që të kujdeset që të mos na ndodh për mosveprim diqka që është e parregullt, e palejueshme, e paligjshme me na ndodh edhe atë që e tha Ymreti apo cilido, e permendi komandantin se jemi deshmitarë. Nuk guxojmë të rrezikojmë të ardhmen, të sotmen, fillimisht të qytetarëve tanë për mos veprim tonin. Ne kemi parkingje mjaft, nuk i kemi të gjitha kushtet për parkingje, ne kemi disa parkingje, madje janë edhe falas, nuk ka në botë parkingje falas, e këtu në qytetin e rahovecit ka, një parking te Hotel Parku, një parking te ato ndërtesat atje nëtë, një parking këtu te komuna, një parking te palestra sportive, ka disa hapsira ku njerzit mund ti vendosin automjetet e veta. Në qoftëse ka pasiguri në ato parkingje, ne jemi ne gjendje me marr përsiper, me kujdestaru, me gjet një kompani të sigurimeve së paku prona e atij që e parkon automjetin në atë parking me qenë e sigurtë. Ju që jeni këtu ne objektin e komunës së Rahovecit përreth objekteve ka makina sepse unë ndoshta po pritoj me ecë në këmbë 50 metra. Pra nuk është që vuajmë shumë për hapësira të lejuara por jemi të pakujdesshëm që duke mos i shfrytëzuar hapsirat e lejuara, dmth hyjmë në veprime të paligjshme. Unë nuk po alarموj asgjë, jemi në normalitet, por do të kërkojë veprim energjik të organeve tona komunale dhe të institucioneve që janë pergjegjëse për me forcu klimën, stabilitetin dhe qendrueshmërinë e sigurisë në komunën tonë. Ne po ashtu kemi, i përmendi baca Ramë, ne e dijmë që aty ku ka ndriçim publik konsiderojmë që është një mundësi, pra është një faktor, një element që ndikon në rritjen e sigurisë në ato vende po ashtu edhe vendosja e kamerave të sigurisë në objekte të rëndësisë së veçantë, le të themi në shkollë, objekte komunale, qendra, aty ku frekuentohet, ku ka dyqane, ku ka biznese, Xhamia, Teqja, pra objektet e rëndësisë së veçantë janë të nevojshme kamerat. Unë po besoj që veq kemi përparuar në këtë drejtim, komandanti e di, dhe po besoj që ne kemi me ju ruajt edhe vetvetës tani prej kamerave, ka një përparim në aspektin teknologjik sa janë në gjendje keto kamera me nxerr fotografinë, spo flasim në 5 apo 10 metra por me kilometra. Unë kisha rekomanduar, kisha kerkuar që ne ta japim bashkërisht kontributin tone, komandanti nuk e permendi një fakt shumë me rëndësi, kriminelët nuk kanë vend këtu, plaqkitësit e armatosur, janë zënë gjitha grupet që kanë operuar kundërligjshëm edhe që i kanë shkaktuar shqetsime familjeve tona, para 3 apo 4 dite, njerëzit kryesor, pra njerëzit që i kanë bërë dëme pronës, familjarëve edhe që kanë operuar edhe në Komunën tonë janë zënë, ata sot janë në trajtim. Nuk do të ketë hapësirë dhe vend për ata që me vetëdije cënojnë interesin e qytetarit tone, të familjeve tona pra shkelin ligjin dhe është e

papranueshme logjika në qoftë se ne e ftojmë policinë ose organet përgjegjëse të tolerohen këto gjëra, ne kemi mundësi të tolerojmë në plot aspekte tjera por nuk guxojmë me i shkel kufinj të ku cenohet jeta e njerzve, prona e njerëzve dhe interesi individual dhe kolektiv i qytetarëve tanë. Ne jemi në gjendje me kry plot obligime tjera, me qenë fleksibil në plot aspekte por aty ku është ligji, aty ku nuk ka sundim të ligjit nuk ja vlen as me jetu aty ku ska ligj, është problem me ia mbush mendjen vetes me jetu ne atë vend. Unë e ftoj Inspektoratin Komunal, Administratën Tatimore të Kosovës edhe Policinë e Kosovës që a ka ndonjë veprimtari ilegale të lojërave të fatit, a ka ndonjë veprimtari ilegale të kazinove, unë nuk kam informata se ato me ligj ju është nderpre veprimtaria e tyre dhe i ftoj edhe në këtë rast të operojnë energjikisht në qoftë se kemi ndonjë burim, ndonjë informatë sepse ne jemi në zbatim të ligjit këtu dhe kemi për detyrë me kriju, me ndërmarrë masa dhe veprime në funksion të asaj që ne e kemi koncept që bashkërisht, dëshirë e vullnet e aspirata sundimin e ligjit. Po ashtu e ftoj Policinë e Kosovës, Inspektoratin tonë, inspektorët e Ministrisë së Mjedisit që t'i ndalin eksploatimet e palejuara, të paligjshme të resurseve tona në këtë rast të rërës, zhavorit apo edhe për shkak se e thash më herët besoj që ne të gjithë jemi të pajtimit që nuk ka me pas vend, nuk duhet me pas vend, nuk duhet me leju që dikush me vepru kundërligjshëm në këtë vend. Shumica le të themi gati shumica absolute e qytetarve kanë dëshirë me pa mirë këtë vend, dëshira e tyre është me pa mire këtë vend, ne nuk mund të ju përmbushim epshet ose orekset e dikujt që merret me drogë, narkotikë ose merret me veprimtari të paligjshme dhe të na demtojë imazhin tonë brenda, ta demtojë kualitetin e jetës tonë brenda, ta demtojë perspektivën e jetës tonë brenda dhe jashtë. Besoj që policia jonë edhe komuna jonë do të jetë e gatshme me kontribu çdo herë në përpjekje për sundim të rendit dhe ligjit e të krijimit të stabilitetit të qetësisë e sigurisë së përgjithshme të qëndrueshme do të punojmë vazhdimisht bashkë, bashkë me antarët e KKS-së, bashkë me Policinë, bashkë me të gjitha organet që kanë për detyrë me kontribu që ne të jemi edhe të qetë edhe të sigurtë edhe të mos kemi, mund të kemi problem se njerëz jemi por problemet të cilat e çenojnë sigurinë nuk kemi arsye me pas. E lus Policinë e Kosovës po ashtu që të ketë kujdes ose të shtoj kujdesin pak më shumë edhe me përdorues të motoçikletave, mua nuk më pengon zhurma sepse ne nuk jemi prej atyre që kemi pas ndonjë jetë të mirë por janë shqetësuese aksidentet që po na ndodhin neve në Rahovec me motoçikleta, e din Komandanti rasti më herët, e di rastin tash, ne vërtetë dmth nuk ka më të tmerrshme se sa me ndëgjua lajme tragjike për humbjen e jetëve. Unë nuk them se është fajtorë Policia por të rrit edhe pak kujdesin, e di që ka pas operime në këtë fushë Policia edhe më herët por të rritë kujdesin që nuk është krejt zhurma se përtej zhurmës humbja e jetës është diçka e papranueshme. Ne kemi levizje të motoçikletave edhe pas ores 24, unë nuk po them se ata po ecin shpejt apo ngadalë se nuk është detyra ime por është mirë edhe në këtë drejtim ndoshta me rritë angazhimin për me pas së paku, mu siguru bashkë që me i marrë masat edhe veprimet e nevojshme që të mos na ndodhin fatkeqësi tjera. Shkollat kanë filluar, nuk kemi ndonjë situatë që ndonjë shkollë nuk ka filluar mësimin dhe ne jemi të vetëdijshëm se ka plot kërkesa dhe shqetësime nëpër shkolla qofshin të nyjes sanitare, qofshin edhe në aspekte të tjera por nuk kemi pas ndonjë problem në fillimin e mbarë të vitit të ri shkollor 2019/2020. Gjithsesi një plan operativ përtej detyrave dhe përgjegjësi që ka DKA-ja, organet e shkollës, këshilli i prindërve, këshilli i nxënësve, këshilli i klasës, edhe policia bashkë me mekanizmat tjerë ka një plan operativ edhe me rritë sigurinë në shkolla edhe me i parandalu ato incidentet potenciale që mundën me ardh si rezultat i asaj që përmendi dikush, i ndonjë thike apo arme tjetër diçka. Besoj që ka një plan operativ dhe bashkë me Drejtorinë e Arsimit dhe bashkë me mekanizma tjerë të Policisë që punon nëpër shkolla, që kanë programe të arrijnë angazhimin për edukim dhe ndërgjegjësim përkthazi me pasojat që mund të ketë shkolla jonë, nxënësit e shkollës, e sotmja dhe e ardhmja jonë nga përdorimi i substancave edhe mjeteve, substancave edhe situatave e që nuk është momenti këtu me fol sepse janë detyra të organeve

kompetente. Te vërshimet, ne veç i kemi fut në prioritet pikat më kritike që i kemi, e që ndër pikat më kritike është qyteti mbase për shkak të pozitës gjeografike, ju e dini për 10 minuta bëhet deti, ne veç kemi angazhuar ekipet e inxhinierëve e që nga viti i ardhshëm do të kemi veprime konkrete në parandalimin e vërshimeve që vijnë kur janë reshjet e stuhishme atmosferike, kuptohet e jona është me i ba punët tona si komunë, me zbutë gjendjen sa te kemi mundësi edhe me i parandalu ato dëmet e mëdha që i kemi pas gjatë kësaj vere, le te themi në amvisëri sidomos ne pjesën poshtë atje. Po ashtu kemi edhe projekte të cilat do të ndikojnë në zbutjen e kërcënimeve që do të vijnë nga vërshimet si nga Krusha e Madhe, Celina, ka Xërxa, do të fillojmë së shpejti prej Hoçës së Madhe deri në Krushe të Madhe, Nagavc e Brestoc, nga Rimniku kemi një projekt edhe Dullon do ta lirojmë edhe pak, pra do ta trajtojmë, sidomos atë zonën ka Stone Castle, atje ku janë disa shkurre, që e kanë vështirësuar qarkullimin e ujit kur ka reshje, por edhe vërshimet edhe pse janë dukuri natyrore, dmth fatkeqësi elementare thirren sipas ligjit, edhe ato mund t'a cenojnë pronën, jetën, ka ndodh që pronën sidomos pasurinë tonë e kanë dëmtuar sepse breshëri, vërshimet, në vitin e kaluar na ka dëmtuar shumë, ne jemi kompenzuar sivjet me një shumë të caktuar që ka qenë satisfaksion moral nga Qeveria e Kosovës por edhe sivjet jemi dëmtuar në zonën e Fortesës, Pataqanit, Rahovecit, Krushës, Celinës, fermerëve tanë që kanë disa prona ka Rugova, detyra jonë është me marrë masa që me rritë sigurinë në të gjitha dimensionet e mundshme, kjo është detyra e përbashkët që besoj që përditë e kemi obligim me dhanë kontributin tonë edhe si mekanizëm i KKS-së por edhe pastaj edhe në përputhje me përgjegjësitë t'i kryemë detyrat secili sipas përgjegjësisë dhe kompetencave që i kemi. Faleminderit shumë!

Në pikën 3: **Të ndryshme**, kisha pas dëshirë nëse ka dikush ndonjë koment, ka ndonjë temë që dëshiron me ngrit, ne e kemi një plan të KKS-së, por në mbledhjen e radhës ne mund të propozojmë edhe diçka KKS-së, spo them me tejkalu planin, por, që ju gjykoni për takimin e radhës në pika të ndryshme jemi. A ka dikush të shtoj diçka? Po urdhëro Komandant!

Komandanti-Kryetar faleminderit, për fjalët e mira, e dhatë gjendjen reale që pasqyrohet deri me tani, kështu që me detyrova tani edhe disa fjalë shtesë, por edhe kërkesa në të njëjtën kohë. Unë që në fillim thash se nuk do të lëshohem në statistika të gjëra duke u marrë me të gjithë periudhën e vitit por faliminderit, edhe atë që e permende, nuk është një rast që ka ndodh tash, e që janë vënë ata në pranga kryesit e këtyre veprave penale, por, mbase hymë ne atë temë, është temë që është diskutuar, por, duhet ta përsërisë prapë, janë gjithsej 5 raste që kanë ndodh vetëm në zonën tonë të përgjegjësisë, grabitje të armatosura, 2 kanë mbetur në tentativë, 3 janë të përfunduara dhe 2 kanë qenë në zonën e përgjegjësisë në Stacionin e Policisë në Gjakovë, mirëpo falë angazhimit ndihmës edhe të qytetarëve edhe gjithë atyre që e kanë dhënë të paktën një fjalë çfardo qoftë mirret si informatë, në bashkëpunim me njësinë e hetimeve rajonale në Gjakovë është arrit që të njëjtit brenda një dite apo një nate shkurt të them për 24 ore janë vënë në pranga dhe kontrollë të Policisë, ku për fat të mirë është dëshmuar me çdo fakt prej fillimit deri në fund, me lëvizje të tyre, me automjete, me targa të vjedhura, me armë, me çorapa, me maska, me patika, është histori e gjatë mos t'i përmendi të gjitha kështu që pranuan apo nuk pranuan e dëshmon fakti, është kryer një punë jashtëzakonisht e mirë, bizneset janë shumë më të qeta se kanë qenë kryesisht me veprimtari që kanë ndodh në biznese, është shumë e qartë nga më të ndryshmet por për neve ka qenë një aktivitet që ja vlen për tu përmendur, mbi të gjitha pas shumë muajve u arrit grupi i tillë të del para drejtësisë. Është rasti tjetër madhor, është festivali që është mbajt Hardhfesti që është mbajtur gjatë 3 ditëve dhe 3 netëve rresht, prapë deshta me cekë se ka qenë për të mirë, nuk ka asnjë rast të vetmin që na ka ndodh gjatë 3 netëve dhe 3 ditëve, duke përfshirë eskorta, vizita e Presidentit, Kryeministrit edhe duke marrë parasysh se numri i pjesëmarrësve ka variuar nga 5000-6000 e deri ne 8000 njerëz, kjo për neve është një rezultat shumë i mirë për të tjerët se di por është rezultat për të gjithë edhe të komunës së Rahovecit edhe për të gjithë që kanë

marr pjesë aty, do të thotë ka kaluar pa ndonjë aksident më të vogël, keni qenë pjesëmarrës i çdo nate. edhe ju aty prezent kështu që, ia vlen të permendet edhe që është bërë një punë e mirë. Në anën tjetër kalohet te bizneset, te ankesat e qytetarve, kështu që publikisht po e kërkoj e që është kërkesë edhe imja edhe nga pronarët e bizneseve edhe nga përfaqësuesit fetar por edhe nga gjithë qytetarët e rajonit në përgjithësi, nga bizneset kisha kërkuar që mos të paraqesin ankesa pa nevojë. E di që ka pas shqetësime edhe tek ju, se mos të jetë e interpretuar edhe ajo, mirëpo çka policia fajtor, se ndoshta dikush mendon që policia ndien kënaqësi kur shqipton gjobë, ama jo, është shume e dhimbshme dhe e ndieshme kur një Polic i shqipton një dënim dikujt, duke e marr parasysh realitetin tonë se ku gjindemi ne dhe në çfarë kushte jetojmë, mirpo jemi detyruar të ofrojmë siguri çdo qytetari. Unë me keqardhje e them, se jam dëshmitar, edhe shumë qytetarë të Rahovecit që më shohin ndonjëherë me tiketë blloka në dorë, mua personalisht, ndoshta e ndiej ndonjë keqardhje por jo është krenari, unë ja garantoj mundësinë një femije, një nëne, një motre që shpesh i shoh në karrocë për dore, edhe duhet me kalu komplet një pjesë të rrugës, sa do qoftë e gjatë që është nëpër shiritin qarkullues ku qarkullojnë automjetet. Për mua është e papranueshme, është turp prandaj kemi raste tjera ku parkimi është i dyfishtë, është realitet dhe ka dëshmi që rrethi në qendër, ai rreth sadoqë është i vogël është dëmtuar, është riparuar për fat të mirë mirëpo çka ndodh ajo, janë dy apo tre parkingje perveç atij që është i paraparë para Shtëpisë së Kulturës, kështu që kisha kërkuar edhe prej bizneseve edhe prej insitucioneve të përfaqësuesve zyrtar mos ta marrin veprimin e Policisë, se janë ka i bëjnë apo po i shqiptojnë ato gjoba vetëm për me ndeshku dikënd apo për qëllime të caktuara apo ku ta di çfarë. Të jeni të bindur se sa të jem unë këtu ka me qenë trajtim i barabartë, ka me ju ofru siguri çdo kujt mirëpo kuptohet veprimet e tjera që janë në dëm të secilit do të ndërmmirren, është shumë e paarsyeshme ajo, arsyetimet e këtilla nuk pranohen për mua. Kërkesë tjetër kam për Drejtorin e Inspekcionëve, thjeshtë unë këtu po e shpreh atë kënaqësi se nuk është në rregull siç thuhet edhe vet, nuk është interesante që tri, katër, apo pesë biznese me vite të tëra veprojnë edhe po veprojnë ashtu qysh po duan, nuk e shoh të arsyeshme absolut jo veten në trotuar por edhe jashtë trotuarit janë vendos edhe karriket. Nuk dua të potencojë, dihet shum mirë, është e çartë, prandaj kisha kërkuar prapë që të angazhohen pak më shumë, të bashkëpunojnë, të ofrojnë ndihmë, nuk është problem por dojmë me ofru siguri dhe me qenë trotuari i lirë ashtu si duhet. Publikisht po e them se nuk do të ketë dallim për asnjë nga ana jonë edhe dëgjova kërkesën e kamerave, është e mirëseardhur, jemi në ngjarje shume mirë, është fat i mirë sidomos për neve kish me qenë një ndihmë jashtëzakonisht e madhe për shumicën e rasteve që po ndodhin dhe që po na humbin kohë, po na marrin njerëz, automjete e të gjitha. Ajo kamerë do ta ndriçoj rastin brenda 5 minutave dhe ka me qenë rezultati shumë i mirë dhe shumë fatbardhë si për ne si për qytetarët, si për të gjithë, kështu që në qoftë se mund të ndikoni edhe të gjindet zgjidhje, të gjinden rrugë të ndryshme, që e dijmë procedurën, kish me qenë shume e mirëseardhur që sa ma shpejtë të realizohet ai projekt që është bërë kërkesa. Motoçikletat, nuk është se nuk veprojmë por në disa raste edhe pse duhet të veprojmë e kemi të pamundur, unë personalisht nuk toleroj edhe pse ka projekte, ka pika kontrolli, nuk është mirë, nuk është e drejtë, edhe pse i ka të gjitha të drejtat polici me bo bastisjen, me ndjekje, me emergjencë me të gjitha, por në anën tjetër e shkaktojmë një dëm shumë më të madh, e kam fjalën kryesisht për motoçikletat, nuk po guxojmë t'i ndjekim, nuk po guxojmë t'i ndalojmë. Rrezikshmëria është ekstrem sa i përket motoçikletave, por prapë po them fajtor jemi të gjithë ne, dhe gjithë qytetarët apo prindërit kush do qoftë. Nuk kemi vetëdijesim në atë drejtim, edhe është e pamundur që çdo gjë që i përmendëm deri tash edhe ashtu ne nuk jemi me personel ashtu si duhet me qenë, besa-besë ne bëjmë edhe ka 12 orë shtesë vetëm e vetëm që me siguru edhe me qenë lëvizja e lirë, edhe me pas një siguri më të plotë ashtu qysh kërkohet, ka ndoshta shumë gjëra për me fol por këto janë ato që duhet përsëritur, që fjalimi i juaj ishte shumë me vend. Faliminderit shumë.

Kryetari-Faleminderit Komandant, jemi në pikën të ndryshme,, urdhëro!

Teqja Refai-Faleminderit Kryetar, deshta vetëm një rikujtim. Tani gjendemi në muajin e shenjtë të Muharremit dhe Teqja Refai këtu në Rahovec, ka bërë aktivitete shtesë përpos pesë vakteve të rregullta, kemi edhe një aktivitet me namaz që fillon në 12 pas mesnatës dhe zgjat diku dy orë. Kjo vlen për të gjithë e posaçërisht për Policinë e Kosovës që të jetë në dijeni se kemi lëvizje shtesë të njerëzve do të thotë me qenë në dijeni, se ka janë duke shkuar këta njerëz. Ju faleminderit!

Kryetari - Faleminderit, e kuptoj dhe shpresoj që ne jemi duke kaluar mirë këto ditë, besoj që policia është e vetëdijshme dhe nuk besoj që ka problem. Faleminderit shumë! Besoj që është rasti, pasi që jemi në këtë pikë, ne nuk e kemi byfen në komunë, kështu që depoja për konfiskim të mallit egziston, të gjitha parakushtet edhe kushtet ligjore janë pjekë, besoj që Policia ka për të shoqëruar Inspektoriatin, kemi për të konfiskuar mallin atyre, ata e vendosin aty ku se ka vendin, e dyta inspektorëve të komunës së Rahovecit ua vazhdoj sot përsëri kontratat, ngaqë sot ka skaduar kontrata për punë shtesë. Janë kujdestarë 24 orë edhe të shtunave edhe të dielave, mos quditeni ndonjëherë nëse i shihni me veturë zyrtare të shtunave dhe të dielave. D ti rrisim kapacitetet për të marr masa dhe veprime ndaj keqbërësve, nuk po flasim sepse qëllimi nuk është për të denuar askënd, por ne jemi në monitorim prej meje çdo ditë monitorohem, jam në kamera gjithkrah, i nënshtrohem çdo ditë një formati të mbikëqyrjes nga MAPL-ja, nga organizatat joqeveritare, nga mediat etj, të gjithë jemi përgjegjës para ligjit dhe do të kërkojmë sepse edhe neve na rekomandohet diçka kur ndodh ndonjë aksident i rëndë trafiku, dikush na thotë diçka edhe ndihemi përgjegjës moral sepse na thotë diçka, dikush na thotë se keni vepruar apo s'keni vepruar kështu prandaj nëse është kështu edhe kjo vlen edhe për të parin e komunës edhe për të parin e policisë dhe për secilin. E ftoj KKSB-në të jep kontributin e vet edhe edukativ edhe ndërgjegjësues edhe vetdijësues që nuk do të tolerojmë që nga mosveprimi ynë apo mungesa e vullnetit tonë institucional si udhëheqje pavarësisht çfarë detyra kemi ta cënojmë interesin tonë individual dhe interesin e përgjithshëm të qytetarëve tanë. Do të ju vazhdoj kontratën inspektorëve edhe do të kërkoj edhe më shumë përkushtim dhe operacionalizim sepse ka 120 euro marrin çdo muaj, tash këto janë rrogat tona, por, unë kërkoj prej tyre më shumë angazhime dhe koordinim me policinë e Kosovës, dhe me gjithë organet që prej asaj që përmenda lojërat e fatit, eventualisht nuk kam burime, e deri te këto më të voglat jemi të interesuar të kemi rend dhe qetësi publike po se po, por edhe sundime të ligjit. Faleminderit shumë dhe mirë u pafshim në takimet e radhës, shpresoj të kemi detyra edhe realizim të detyrave deri në takimin tjetër. Faleminderit shumë!

Të nderuar me kaq përfundoi takimi i sodit, ju falënderoj të gjithëve për kontributin e dhënë! Mirupafshim në takimet e radhës!

Mbledhja përfundoi në orën 15:00

Procesmbajtësi

Skënder Hamza

